



Republika e Kosovës / Republic of Kosova
Komuna - Municipality
Hani i Elezit



01/Nr. 624 /2023

Në bazë të Ligjit mbi Vetëqeverisjen Lokale numër Nr. 03/L-40 neni 43, nenit 31 të Statutit të Komunës së Hanit të Elezit, bëjë këtë:

F T E S Ë

Ftoheni që të merrni pjesë në mbledhjen e parë -I- të rregullt për vitin 2023 të Kuvendit të Komunës, e cila do të mbahet me datë 31.01.2023 me fillim pune në ora 11:00 në sallën e Kuvendit të Komunës.

RENDI I PUNËS

1. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar.
2. Raporti financiar për vitin 2022.
3. Propozim vendimi për ndarjen e bursave për studentë për vitin akademik 2022-2023.
4. Plani i punës së këshillave të fshatrave për vitin 2023.
5. Plani i punës së katër komiteteve konsultative për vitin 2023.
6. Plani i punës së këshillit komunal për siguri në bashkësi për vitin 2023.
7. Harmonizimi i rregullores për Transportin Rrugorë në Territorin e Komunës së Hanit të Elezit.
8. Plani i menaxhimit të mbeturinave.
9. Informatë mbi veprimtarit e subjekteve afariste për vitin 2022.
10. Të ndryshme.

Bashkë me ftesën ju dërgojmë:-

- Procesverbalin nga mbledhja e kaluar.
- Materialin e raportit financiar për vitin 2022.
- Materialin e propozim vendimit për ndarjen e bursave për studentë për vitin akademik 2022-2023.
- Materialin e planit të punës së këshillave të fshatrave për vitin 2023.
- Materialin e planit të punës së katër komiteteve konsultative për vitin 2023
- Materialin e planit të punës së këshillit komunal për siguri në bashkësi për vitin 2023.
- Materialin për harmonizimin e rregullores për Transportin Rrugorë në Territorin e Komunës së Hanit të Elezit.
- Materialin e planit për menaxhimit të mbeturinave.
- Materialin e Informatë mbi veprimtarit e subjekteve afariste për vitin 2022.

Hani i Elezit
Data:-23.01.2023





Republika e Kosovës / Republic of Kosovo
Komuna - Municipality
Hani i Elezit



01/Nr. 626 /2023
Data: 23.01.2023

PROCESVERBAL I KUVENDIT TË KOMUNËS

Procesverbali nga mbledhja e dymbëdhjetë -XII- e Kuvendit të Komunës, mbajtur me datë 22.12.2022 me fillim pune në ora 11:00 në sallën e Kuvendit të Komunës. Të pranishëm ishin: **Mehmet Ballazhi** (Kryetar i Komunës), **Natyra Kalisi** (Drejtoresh e Administratës), **Abduraman Bushi** (Drejtor për Bujqësi Pylltari dhe Zhvillim Rural), **Majlinda Kaloshi** (Drejtoresh për Zhvillim Ekonomik), **Kimete Kuka -Hasallari** (Drejtoreshë për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale), **Nexhmedin Daci** (Drejtor për Urbanizëm Kadastër dhe Mbrojtje të Mjedisit), **Lindita Ballazhi** (Drejtoresh për Buxhet dhe Financa), **Hisni Luri** (Drejtor për Arsim, Kulturë, Rini dhe Sport), **Arsim Dernjani** (Drejtor për Shërbime Publike dhe Emergjencë), **Sara Berisha** (Asistente e Kryesuesit të Kuvendit të Komunës), **Vjosa Rogaçi** (Zyrtare për Barazi Gjinore), **Bashkim Sopa** (Zyrtarë për Informim), Përfaqësuesi i OSBS-së. Kryesuesi pasi konstatoi prezencën e anëtarëve të kuvendit, konstatoi se nuk mungon asnjë anëtarë i Kuvendit të Komunës.

RENDI I PUNËS

1. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar.
2. Plani i punës së ekzekutivit të komunës së Hani të Elezit për vitin 2023.
3. Plani i punës së komitetit për komunitete për vitin 2023.
4. Propozim vendim për dhënien në shfrytëzim të pronave të Kuvendit të Komunës për vitin 2023.
5. Raporti i auditorit të brendshëm për vitin 2021 dhe gjashtë mujorin e 2022.
6. Plani i veprimt të rekomandimeve të auditorit të brendshëm për vitin 2021 dhe gjashtë mujorin 2022.
7. Raporti për planin e integritetit për vitin 2022.
8. Informatë për gjashtëmbëdhjetë ditët e aktivizimit kundër dhunës në baza gjinore.
9. Të ndryshme.

Kryesuesi thekson:- për pika e rendit të punës hapi diskutimin,

Ibadete Kalisi thekson:- në emër të grupi parlamentarë të Partisë Demokratike propozoj që në rend pune të shtohet edhe një pikë e rendit të punës për shkak kemi pranuar një kërkesë nga Qendra e “Gjenocidit në Kosovë-Plagë e hapur” dhe në disa asamble komunale është miratuar si deklaratë. Miratimi i deklaratës që lulëkuqja me katër petale të bëhet simbol unik i përkujtimor i gjenocidit në Kosovë.

Kryesuesi thekson:- a keni edhe ndonjë diskutim për pikën shtesë që u propozua, nëse nuk ka e hedh në votim; rezultati i votimit ishte njëzëri. Në tërësi e hedh në votim rendin e punës, rezultati i votimit ishte njëzëri.

Procedojmë me këtë rend të punës:-

1. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar.
2. Plani i punës së ekzekutivit të komunës së Hanit të Elezit për vitin 2023.
3. Plani i punës së komitetit për komunitete për vitin 2023.
4. Propozim vendim për dhënien në shfrytëzim të pronave të Kuvendit të Komunës për vitin 2023.
5. Raporti i auditorit të brendshëm për vitin 2021 dhe gjashtë mujorin e 2022.
6. Plani i veprimit të rekomandimeve të auditorit të brendshëm për vitin 2021 dhe gjashtë mujorin 2022.
7. Raporti për planin e integritetit për vitin 2022.
8. Informatë për gjashtëmbëdhjetë ditët e aktivizimit kundër dhunës në baza gjinore.
9. Miratimi i deklaratës që lulëkuqja me katër petale të bëhet simbol unik i përkujtimor i gjenocidit në Kosovë.
10. Të ndryshme.

1. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar.

Kryesuesi thekson:- a keni ndonjë vërejtje rreth procesverbalit, nëse nuk ka e hedh në votim; rezultati i votimit ishte njëzëri.

U MIRATUAR PROCESVERBALI NGA MBLEDHJA E KALUAR

2. Plani i punës së ekzekutivit të komunës së Hanit të Elezit për vitin 2023.

Kryesuesi thekson:- për këtë pikë të rendit të punës hapi diskutimin.

Mehmet Ballazhi thekson:- dje kemi pasur një dëgjim publik për planin e punës së ekzekutivit të komunës së Hanit të Elezit për vitin 2023 dhe e kemi prezantuar para qytetarëve . I kam përcaktuar objektivat në plan për vitin 2023 në raport me buxhetin të cilin e ka miratuar kuvendi i komunës. Materialin e keni pranuar me kohë dhe nëse keni ndonjë propozim mund të parashtroni.

Kryesuesi thekson:- a keni edhe ndonjë diskutim për këtë pikë të rendit të punës, nëse nuk ka e hedh në votim; rezultati i votimit ishte njëzëri.

U MIRATUA PLANI I PUNËS SË EKZEKUTIVIT TË KOMUNËS SË HANIT TË ELEZIT PËR VITIN 2023

3. Plani i punës së komitetit për komunitete për vitin 2023

Kryesuesi thekson:- për këtë pikë të rendit të punës hapi diskutimin, nëse nuk ka e hedh në votim; rezultati i votimit ishte njëzëri.

U MIRATUA PLANI I PUNËS SË KOMITETIT PËR KOMUNITETE PËR VITIN 2023

4. Propozim vendim për dhënien në shfrytëzim të pronave të Kuvendit të Komunës për vitin 2023.

Kryesuesi thekson:- për këtë pikë të rendit të punës hapi diskutimin.

Nexhmedin Daci thekson:- drejtorja e urbanizmit ka përgatitur një listë të pronave të cilat janë në emër të komunës dhe parashihen që të ipen në shfrytëzim në vitin 2023 sipas legjislacionit në fuqi. Sipas ligjit të gjitha komunat në Kosovë janë të obliguara që ta publikojnë listën e pronave dhe listën e veçantë të pronave të cilat parashihen të ipen në shfrytëzim . Kjo listë duhet të publikohet në veb faqe të komunës më së voni deri me tridhjetë e një dhjetorë.

Ajnure Thaçi thekson:- pronat të cilat planifikohen të ipen në shfrytëzim a i ka kërkuar ndonjë palë për me i shfrytëzuar.

Sherif Berisha thekson:- sa është sipërfaqja e këtyre pronave që planifikohen të ipen.

Hyriete Isufi thekson:- a janë në shfrytëzim prej dikujt këto prona.

Refet Kalisi thekson:- parcelat të cilat planifikohen të ipen a janë kullosa apo edhe pyje.

Nexhmedin Daci thekson:- jo nuk i ka kërkuar por ju e dini që komuna jonë nuk ka prona ndërtimore por këta prona i kemi dhe i kemi planifikuar për këtë çështje. Të dhënat për këto prona i kemi në bazë të dhënave të kadastrit. Pronat nuk janë të rrethuar nga personat privat. Parcelat me numër 73317070-00927-0 zona kadastrale Pusteni vendi quajtur Nikona sipërfaqja në metra katrorë 11710 me kulturë arë e klasit 8. Parcelat me numër 73317055-00963 Zona kadastrale Krivenik Kodra Rojt, sipërfaqja në metra katrorë 4038 me kulturë kullosë e klasit 6. Parcelat me numër 73317070-00946-0 Zona kadastrale Pusteni në vendin e quajtur Tanask sipërfaqja 8906 kullosë e klasit 4. Parcelat me numër 73317073-00792-0 Zona kadastrale Rezhancë Vendi i quajtur Ortica sipërfaqja 19461 me kulturë Kullosë e klasit 6. Parcelat me numër 73317073-00789-1 Zona kadastrale Rezhancë Vendi i quajtur Gjuri sipërfaqja 9510 me kulturë Kullosë e klasit 5.

Zaim Bela thekson:- e di që është edhe një pronë komunale në vendin e quajtur Kashan dhe nuk kam informacion se a është shpronësuar apo jo por në listë nuk shënon.

Nexhmedin Daci thekson:- nuk është në emër të kuvendit të komunës dhe një pjesë është shpronësuar.

Kryesuesi thekson:- a keni edhe ndonjë diskutim për këtë pikë të rendit të punës, nëse nuk ka e hedh në votim; rezultati i votimit ishte njëzëri.

U MIRATUA PROPOZIM VENDIMI PËR DHËNIEN NË SHFRYTËZIM TË PRONAVE TË KUVENDIT TË KOMUNËS PËR VITIN 2023

5. Raporti i auditorit të brendshëm për vitin 2021 dhe gjashtë mujorin e 2022.

Kryesuesi thekson:- për këtë pikë të rendit të punës hapi diskutimin.

Lindita Ballazhi thekson:- në mungesë të auditorit të brendshëm në komunë kemi kërkuar shërbime nga Ministria e Financave për të bërë auditimin për vitin 2021 si dhe gjashtë mujorin e vitit 2022 . Në bazë të raportit Ministria e Financave ka nxjerr nëntë të gjetura të cilat i kemi paraqitur në material.

Ajnure Thaçi thekson:- sa rekomandime i takojnë periudhës së vitit 2021 dhe sa i takojnë gjashtë mujorit të vitit 2022

Lindita Ballazhi thekson:- te raporti final nuk janë të ndara vitet por është raport final për të gjitha të gjeturat.

Hyriete Isufi thekson:- çështja e shpenzimeve të subvencioneve duhet të mbikëqyret se a po kanë efekt ata subvencione dhe dedikimi i tyre se ku dedikohen.

Lindita Ballazhi thekson:- është e gjetur prej zyrës kombëtare të auditimit në lidhje me subvencion që nga momenti i shpalljes së njoftimit për subvencioneve deri në momentin jepen subvencionet dhe faza tjetër monitorimi i subvencioneve. Auditorët e jashtëm të zyrës kombëtare të auditimit e kanë kryer deri në gjashtë mujorin parë të vitit 2022 por për vitin 2021 dhe pastaj kjo ka qenë e gjetur prej zyrës kombëtare të auditimit për vitin 2021, megjithatë auditorët e brendshëm nga Ministria e Financave kanë rekomanduar si rekomandim të njëjtat të gjeturat në lidhje me subvencionet por ne prej kësaj të gjeture 90 % kemi filluar me zbatuar dhe kemi bërë planin e ndarjes së subvencioneve, kemi caktuar zyrtarin përgjegjës për monitorimin e subvencioneve dhe jemi në fazat përfundimtare të hartimit të raportit të ndarjes së subvencioneve.

Resul Suma thekson:- a ka ndonjë rekomandim që nuk mundet me u zbatuar.

Lindita Ballazhi thekson:- shumica e rekomandimeve janë të zbatueshme dhe ekzistojnë disa rekomandime si tejkalimet e kodeve buxhetore që nuk mundet në përpikmëri të zbatohet për shkak se ndryshe është planifikimi dhe pastaj janë disa punë të tjera që duhet të dalim jashtë planifikimit por ata zakonisht bëhen me vendime të Kryetarit të Komunës .

Kryesuesi thekson:- a keni edhe ndonjë diskutim për këtë pikë të rendit të punës, nëse nuk ka kalojmë në pikën e radhës të paraparë sipas agjendës.

6. Plani i veprimit të rekomandimeve të auditorit të brendshëm për vitin 2021 dhe gjashtë mujorin 2022.

Kryesuesi thekson:- për këtë pikë të rendit të punës hapi diskutimin.

Lindita Ballazhi thekson:- sipas legjislacionit në fuqi komuna ka përgatitur planin e veprimit të zbatimit të rekomandimeve të cilat janë dhënë nga auditorët e brendshëm nga Ministria e Financave. Kemi bërë komisionin për planin e veprimit dhe është hartuar plani se si do t'i reduktojmë këto të gjetura.

Kryesuesi thekson:- a keni edhe ndonjë diskutim për këtë pikë të rendit të punës, nëse nuk ka kalojmë në pikën e radhës të paraparë sipas agjendës.

7. Raporti për planin e integritetit për vitin 2022.

Kryesuesi thekson:- për këtë pikë të rendit të punës hapi diskutimin.

Natyra Kalisi thekson:- raporti është hartuar në pajtim me legjislacionin në fuqi si dhe strategjinë kundër korrupsionit që e obligonë komunën me pasur një plan të integritetit por në të njëjtën kohë me raportuara mbi masat e rrezikshmërisë të institucionit tonë . Duke ditur që është një periudhë kohore e shkurtër nga miratim në kuvend të planit të integritetit që është miratuar në muajin e tetë kemi arritur me i përmbushur disa objektiva të këtij plani.

Kryesuesi thekson:- a keni edhe ndonjë diskutim për këtë pikë të rendit të punës, nëse nuk ka kalojmë në pikën e radhës të paraparë sipas agjendës.

8. Informatë për gjashtëmbëdhjetë ditët e aktivizimit kundër dhunës në baza gjinore.

Kryesuesi thekson:- për këtë pikë të rendit të punës hapi diskutimin.

Vjosa Rogaçi thekson:- ne kemi kontaktuar me Qendrën për Punës Sociale dhe me Stacioni Policorë dhe ata kanë potencuar se për gjashtëmbëdhjetë ditët e aktivizimit kundër dhunës në baza gjinore nuk ka pasur asnjë rast.

Kryesuesi thekson:- a keni edhe ndonjë diskutim për këtë pikë të rendit të punës, nëse nuk ka kalojmë në pikën e radhës të paraparë sipas agjendës.

9. Miratimi i deklaratës që lulëkuqja me katër petale të bëhet simbol unik përkujtimor i gjenocidit në Kosovë.

Kryesuesi thekson:- për këtë pikë të rendit të punës hapi diskutimin.

Ibadete Kalisi thekson:- materiali është shpërndarë nga sekretaria dhe i përmban të gjitha pika se çka ka të bëjë lulëkuqja me katër petalet. Është mirë të përkrahet dhe të miratohet si deklaratë edhe në kuvendin e komunës së Hanit të Elezit.

Mehmet Ballazhi thekson:- është historik i lulëkuqes me katër petalet si simbol i botës i gjenocidit të dhunës dhe disa kuvend të komunave e kanë miratuar për me qenë një simbol unik përkujtimorë i gjenocidit në Kosovë në mënyrë që mos me dalur me një simbol ndryshe secila komunë por me qenë unike siç e kanë shumë vende të botës .

Kryesuesi thekson:- a keni edhe ndonjë diskutim për këtë pikë të rendit të punës, nëse nuk ka e hedh në votim; rezultati i votimit ishte njëzëri.

U MIRATUA DEKLARAT QË LULKUQJA ME KATËR PETALE TË BËHET SIMBOL UNIK PËRKUJTIMORË I GJENOCIDIT NË KOSOVË

10. Të ndryshme.

Kryesuesi thekson:- për këtë pikë të rendit të punës hapi diskutimin.

Zaim Bela thekson:- sa nxënës në secilën shkollë veç e veç ka mangut prej vitit 2021 në vitin 2022.

Hanumshahe Dibrani thekson:- në mbledhjen e kaluar drejtorit për shërbime publike potencoj se vetëm do të bëhet testimi të fabrika e ujit por a është bërë diçka në këtë drejtim.

Resul Suma thekson:- a ka marr komuna ndonjë mas për mi parandaluar shitjen e mjeteve piroteknike

Erbilin Maliqi thekson:- në mbledhjen e kaluar kam parashtruar pyetje për drejtorinë e arsimit rreth problemit të transportit për nxënësit të cilët e ndjekin mësimin në shkollën e mesme në qytetin e Ferizajt . A ka pasur ndonjë lëvizje në zgjidhjen e këtij problemi. Kërkoj që vazhdohet me rregullimin e përrorskës në vendin e quajtur Kollomoqe deri tek penda sepse nëse rregullohet kjo bëhet edhe hapja e rrugës për pronat të cilët çdo herë e kanë pasur këtë problem.

Hisni Luri thekson:- sa i përket numrit të nxënësve do ta përcjelli. Për transportin e nxënësve nuk kemi bërë asnjë lëvizje për shkak se duhet të kemi mjete financiare për këtë çështje. Kryetari i komunës ka diskutuar me ata të linjave për me bërë një orar por është e pa mundur këtë ndryshim aty për aty por parasysh e kemi dhe do të mundohemi me bërë një zgjidhje në të ardhmen.

Mehmet Ballazhi thekson:- në planin e punës që u miratua si pikë e parë nën objektivë për vitin 2023 stimulim i nxënësve në shkollat profesionale me mbulim të shpenzimeve të udhëtimit dhe studentët e suksesshëm me bursa studentore. Çështjen e mjeteve piroteknike e kemi diskutuar edhe me policinë por janë të ndaluara me Ligj.

Arsim Dernjani thekson:- punë kryesi të gjitha kërkesat që i ka pasur prej komunës ja kemi kryer, po ashtu i kemi kryer edhe punimet me KEDS-in , ndërsa punë kryesi ka pasur punë një javë ditë por ne nuk kemi kompetenca për me i dhënë ndonjë ndëshkim punë kryesit përveç që i kemi bërë telefon por nuk e ka hapur telefonin. Të gjitha punët të cilat u kanë takuar komunës i kemi kryer .

Mehmet Ballazhi thekson:-skepticizmin për çështjen e fabrikës që ndoshta nuk do t'i plotëson kërkesat për ujë e kam shprehur në fillim po angazhimi jonë është që na ta funksionlizojm fabrikën që ato kapacitete të ujit të cilat janë me qenë uji i pishëm . E kam sqaruar edhe herëve të tjera që tridhjetë mijë euro i kemi ndarë për vendosjen e ujë matësve edhe pse nuk e kemi pasur të obliguar me ligj por i kemi ndarë për me shtijë në menaxhim ujin dhe nëse kompania “Bifurkacion”, kompania “Teuta” si punë kryes, qeveria Zvicerane e cila e ka financuar këtë projekt do të thotë janë çështje të tyre dhe ne si komunë jemi në rregull por kemi dalur për përtej mundësive për me lëshuar në funksion fabrikën. Ju e dini që afër tre muaj ka zgjatur afati i neglizhencës së KEDS-it për me i vendosur shtyllat.

Sherif Berisha thekson:- përgjigjet për mëditjet për muajin qershor dhe muajin shtatorë nuk i kam pranuar me kohë.

Lindita Ballazhi thekson:- listën për shtesa dhe mëditje e kemi përcjell në muajin tetor.

Sherif Berisha thekson:- unë nuk e kam pranuar këtë material.

Xhevahir Dernjani thekson:- janë shumë punë duke u kryer në fund vit. Ka filluar faza e parë e rrugës dy Korriku në fshatin Paldenicë dhe në momentin që do të asfaltohet kjo rrugë është në dobi të qytetarëve të fshatit Paldenicë. Janë duke u zhvilluar punimet për Parkun e Qytetit por shumë i kënaqur se që njëzet e dy vite pas luftës po e shohë një pllakë përkujtimore për nxënësin Isa Berisha. Është mirë që është bërë ndriçimi i qytetit dhe ju uroj festën e vitit të ri.

Resul Suma thekson:-llaptopët që na u kanë siguruar si asamblistë çështja e kontratës së vindsit i ka skaduar është mirë që me kontaktuar me kontraktuesin që me najë dërguar edhe kontratën e vindsit

Hanumshahe Dibrani thekson:- a ju është bërë ndonjë kontroll nxënësve nëpër shkolla.

Kryesuesi thekson:- a ka logoped në shkolla dhe ku ka mbetur çështja e profesorit të fizikës.

Kimete Kuka -Hasallari thekson:- e kemi diskutuar me drejtoreshën e QKMF-së për një kontroll sistematike nëpër të gjitha shkollat por kemi pritur që të pranohet edhe stomatologu në mënyrë që të bëhen dy kontrollat së bashku .

Hisni Luri thekson:- e kemi një asistente për fëmijët me nevoja të veçanta që aktualisht e ka profesionin e logopedisë, mirëpo nuk punon si logopede por për vitin 2023 kemi planifikuar që me rekrutuar edhe një logopede . Sa i përket profesorit të fizikës dhe është përmbyllur afati i aplikimit që kemi shpresuar që deri tash me rekrutuar një profesional, në mungesë të kësaj dhe të procedurave të gjata i kemi angazhuar dy mësimdhënës profesional të lëndës së fizikës, i kemi ndarë orët që të përmbyllet gjysmëvjetori që mos me mbetur pa nota edhe pse e di që notat ndoshta nuk do të jenë shumë reale dhe këtë pjesë duhet me kuptuar po kjo pjesa që kanë mbetur nxënësit pa mësimdhënës ka qenë vështirësia më e madhe që e kemi pasur si drejtori. Kemi me pasur vështirësi për rekrutimin e lëndëve siç është matematika, gjuha Gjermane dhe lënda e Fizikës.


Kryesuesi thekson:- a keni edhe ndonjë diskutim për këtë pikë të rendit të punës, nëse nuk ka shpalli të mbyllur mbledhjen.

Ju faleminderit për pjesëmarrje.

Mbledhja përfundoi në ora 12:10

Procesmbajtësi

Ayni Bushi





Republika e Kosovës - Republic of Kosovo

Komuna – Municipality

Hani i Elezit



04/265/2023

Data: 10/01/2023

DREJTORIA PËR BUXHET DHE FINANCA

RAPORTI FINANCIAR PËR PERIUDHËN JANAR-DHJETOR 2022

Hani i Elezit, Janar 2023

PËRMBAJTJA

1. Përkufizimet.....	3
2. Hyrje.....	5
2.1 Performanca e të hyrave.....	5
2.2 Performanca e shpenzimeve.....	5
3. Buxheti i Komunes Hani i Elezit 2022.....	7
4. Ndarjet fillestare dhe finale të buxhetit të Komunës Hani i Elezit.....	8
5. Planifikimi dhe realizimi i buxhetit për vitin 2022 si dhe krahasimi 2022/2021.....	9
6. Raporti i ekzekutimit të buxhetit për vitin 2022 sipas drejtorive.....	11
7. Ekzekutimi i buxhetit të vitit 2022 sipas burimit të financimit.....	17
8. Shpenzimet sipas kodeve ekonomike.....	19
8.1. Shpjegime për kategorinë ekonomike mallra dhe shërbime	21
8.2 Shpjegime për kategorinë ekonomike subvencione dhe transfere.....	29
9. Financimi i Investime Kapitale Komunale për vitin 2022.....	30
10. Raporti i të hyrave vetanake janar-dhjetor 2022	33

1.Përkufizimet

Bilancet - shumat e zotimeve të papritura, ndarjeve buxhetore të pa alokuara, alokimet e pa zotuar dhe çfarëdo të ardhurash të një shume më të madhe se sa shuma e shpenzimeve dhe zotimet e papritura të bartura nga viti fiskal paraprak;

Organizatat Buxhetore – të gjitha ministrinë, komunat, agjencitë dhe institucionet, të cilat pranojnë ndarje buxhetore nga Fondi i Kosovës sipas këtij ligji;

Zotimet - shpenzimet e parashikuara, për të cilat urdhëresa për pagesë të zotimit është plotësuar në pajtim me Rregullat Financiare të Thesarit dhe të cilat janë regjistruar në SIMFK, pa marrë parasysh nëse i nënshtrohen apo jo ndonjë detyrimi ligjor;

Kategoritë e shpenzimeve - kategoritë “Pagat dhe Shtesat”, “Mallrat dhe Shërbimet”, “Shërbimet Komunale”, “Subvencionet dhe Transferet” , “Shpenzimet Kapitale” dhe “Rezervat”.

Viti fiskal - periudhën nga 1 Janari i një viti deri 31 dhjetor të vitit të njëjtë;

Alokimi i fondeve – shuma maksimale për zotime dhe shpenzime që mund të bëhet kundrejt ndarjeve specifike buxhetore, siç është përcaktuar me procedurat e parapara në nenin 34 të LMFPP-së dhe të regjistruara në SIMFK;

Subvencionet – fondet e siguruar nga shteti për të ndihmuar kompanitë, personat juridik ose sektorët e veçantë të ekonomisë si për shembull bujqësia;

Korniza Afatmesme e Shpenzimeve KASH– Është një dokument i prioriteteve të politikave të Qeverisë që ka për qëllim orientimin e ndarjes së mjeteve buxhetore gjatë procesit të ardhshëm buxhetor. Përkrah parashikueshmërinë në procesin e buxhetit duke siguruar se buxheti bazohet në parashikimin afatmesëm makroekonomik dhe fiskal (zakonisht në një periudhë 3 vjeçare);

Të hyrat vetanake të komunave - çfarëdo e hyre e parasë publike e cila është vlerësuar dhe mbledhur nga komunat nga burimet e specifikuara në nenin 8 të Ligjit Nr. 03/L-049 për Financat e Pushtetit Lokal, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin Nr. 05/L-108;

Burimet e financimit – grantet qeveritare (GQ), të hyrat vetanake (THV), të hyrat e dedikuara (THD), të hyrat nga AKP-ja dhe financimet nga huamarrja brenda deficitit buxhetor (FH);

Transferet - Çdo ndryshim i ndodhur brenda ndarjeve të aprovuara të paraqitura në tabelat 3.1, 3.1A, 3.1 B, 3.2, 3.2B, 4.1, dhe 4.2 nënkupton transferet që janë:

- ndryshimi i shumave të ndara në mes të organizatave buxhetore,
- ndryshimet që ndodhin mes nën-programeve të po të njëjtës organizatë buxhetore dhe
- ndryshimet e ndodhura mes secilës kategori të shpenzimeve të paraqitur në tabelën 3.1,3.1A, 3.1B, 3.2, 3.2B, 4.1, dhe 4.2.

Rialokimet - Çdo ndryshim i ndodhur në tabelën 3.2, 3.2B; dhe 4.2 në kategorinë e shpenzimeve kapitale brenda një nën-programi të një organizate buxhetore;

2. Hyrje

Raporti financiar për periudhën janar - dhjetor 2022, është përgatitur në bazë të Ligjit Nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë, të dispozitave të nenit 45, paragrafët 45.2 dhe 45.4, si dhe Statutin e Komunës së Hanit të Elezit të nenit 51, paragrafi 5.

Ky raport përmban një përmbledhje të trendeve kryesore të të hyrave dhe shpenzimeve buxhetore përgjatë periudhës janar - dhjetor 2022. Raporti përmban analiza përmbledhëse të periudhës përkatëse, pasqyron të hyrat sipas drejtorive, sipas llojit të të hyrave si dhe krahasimet me periudhat paraprake dhe projeksionet buxhetore.

2.1 Performanca e të hyrave

Të hyrat vetanake kanë arritur vlerën e arkëtimit 334,001.67 euro apo 88% e planit të të hyrave të planifikuara.

2.2 Performanca e shpenzimeve

Shpenzimet buxhetore kanë arritur vlerën prej 2,685.088.65€ apo 91.52% e projeksioneve buxhetore të vitit 2022 që kanë qenë në shumë prej 2,933,774.29 €, ndërsa në krahasim me shpenzimin e vitit paraprak kemi një rënie prej 1.9% apo 50,625.18 €.

- ❖ **Shpenzimet për paga dhe shtesa** - Shpenzimet në këtë kategori ekonomike janë 1,675,828.92 apo 95.12% në krahasim me ndarjen fillestare. Bazuar në vendimet nga Qeveria e Republikës së Kosovës janë ndarë mjete shtesë për personelin shëndetësor dhe stafin mbështetës që janë të ekspozuar drejtëpërdrejtë me rrezikun nga Covid-19 në vlerën 20,286 €, për shtesat mujore mbi pagën bazë.
- ❖ **Shpenzimet për mallra dhe shërbime** shënuan vlerën prej 396,616.33€ duke arritur kështu normën e ekzekutimit 96.56%.
- ❖ **Shpenzimet komunale** shënuan vlerën prej 67,684.20€ duke arritur kështu normën e ekzekutimit 99.98% krahasuar me vlerën totale vjetore të buxhetuar për këtë kategori.
- ❖ **Shpenzimet për subvencione dhe transfere** arritën shumën prej 85,967€ duke arritur

kështu normën e ekzekutimit 98.81% krahasuar me vlerën totale vjetore të buxhetuar për këtë kategori.

- ❖ **Shpenzimet kapitale** arritën vlerën prej 458,992.20 € që paraqet një normë të lartë të ekzekutimit në 75.68% krahasuar me vlerën totale vjetore të buxhetuar për këtë kategori.

3. BUXHETI I KOMUNËS SË HANIT TË ELEZIT PËR VITIN 2022

Buxheti i komunës së Hanit të Elezit i ndarë sipas ligjit me nr. 08/L-066 mbi ndarjet buxhetore të Republikës së Kosovës për vitin 2022 ka qenë në lartësi prej **2,759,758.00€**.

Ky buxhet është ndarë sipas kategorive ekonomike si në vijim:

- Paga dhe shtesa 1,756,083.00 €,
- Mallra dhe shërbime..... 385,975.00 €,
- Shpenzimet komunale67,700.00 €,
- Subvencione dhe transfere... 80,000.00 €,
- Shpenzime kapitale 455,000.00 €,
- Rezervat.....15,000.00€,
- Totali i buxhetit.....2,759,758.00 €.

Ndërsa buxheti përfundimtar është në shumë prej **2,995,979.29 €**, që d.m.th. është rritur buxheti edhe për **236,221.29 €** duke përfshirë:

- ❖ Bartjen e mjeteve të pashpenzuara nga të hyrat vetanake të vitit 2020 dhe 2021 në shumë prej **72,737.76 €**;
- ❖ Grant shtesë për projektin kapital “Shtimi i kapaciteteve të ujit dhe rregullimi i rrjetit të ujësjellësit” në vlerë prej **37,150.00 €**;
- ❖ Donacion prej IPA Fondeve për projektin “ Mbrojtja e mjedisit përmes përmirësimit të ujërave të zeza dhe Kanalizimeve Atmosferike” në shumë prej **62,124.45 €**;
- ❖ Bazuar në vendimet nga Qeveria e Republikës së Kosovës nr: 09/56 të datës 26.01.2022 (Janar-Qershor) dhe vendimi nr: 12/89 të datës 20.07.2022 (Korrik-Dhjetor) janë ndarë mjete shtesë për personelin shëndetësor dhe stafin mbështetës që janë të ekspozuar drejtëpërdrejtë me rrezikun nga Covid-19 në vlerë prej **20,286.00 €** mbi pagën bazë.
- ❖ Donacion nga Qeveria Japoneze për projektin “Ndërtimi i aneksit për këmbësor në urën e Seçishtës”, në vlerë prej **43,809.00 €**;
- ❖ Donacione të mbetura të cilat janë bartur nga vitet e kaluara në vlerë prej **114.08 €**.

4.NDARJET FILLESTARE DHE FINALE TË BUXHETIT PËR VITIN 2022

<i>Kategoritë ekonomike</i>	<i>Ndarjet Buxhetore Nr: 08/L-066</i>	<i>Bartja e THV nga 2020 dhe 2021</i>	<i>Grant shtesë prej</i>	<i>IPA fonde</i>	<i>Donacione të bartura</i>	<i>Donacion nga Qeveria Japoneze</i>	<i>Financimi nga huamarrjet</i>
<i>Paga dhe shitesa</i>	1,756,083			3,880.58			20,286
<i>Mallra dhe shërbime</i>	385,975	21,800		2,984.43	0.50		
<i>Shpenzime Komunale</i>	67,700						
<i>Subvencione dhe transfere</i>	80,000	7,000					
<i>Shpenzime Kapitale</i>	455,000	43,937.76	37,150.00	55,259.44	114.08	43,809	
<i>Rezerva</i>	15,000						
Total	2,759,758	72,737.76	37,150	62,124.45	114.58	43,809	20,286

5.PLANIFIKIMI DHE REALIZIMI I BUXHETIT PËR VITIN 2022 SI DHE KRAHASIMI 2022/2021

<i>Kategoritë ekonomike të shpenzimeve</i>	<i>Buxheti 2022</i>	<i>Realizimi janar- dhjetor 2022</i>	<i>%</i>	<i>Buxheti 2021</i>	<i>Realizimi janar- dhjetor 2021</i>	<i>%</i>	<i>Krahasimi në euro 2022/21</i>	<i>Krahasimi në % 2022/21</i>
<i>Paga dhe shitesa</i>	1,761,853.58	1,674,681.79	95.05%	1,645,045.11	1,645,045.11	100.00%	29,636.68	1.80
<i>Mallra dhe shërbime</i>	410,759.93	396,616.33	96.56%	355,065.39	348,741.08	98.22%	47,875.25	13.73
<i>Shpenzime komunale</i>	67,700.00	67,684.20	99.98%	65,100.00	64,899.87	99.69%	2,784.33	4.29
<i>Subvencione dhe trans.</i>	87,000.00	85,967.00	98.81%	80,290.00	72,465.00	90.25%	13,502.00	18.63
<i>Shpenzime kapitale</i>	606,460.78	458,992.20	75.68%	533,593.31	503,312.41	94.33%	(44,320.21)	(8.81)
<i>Rezervat</i>	-	-	-	55,000.00	-		-	-
<i>TOTALI</i>	2,933,774.29	2,683,941.52	91.48%	2,734,093.81	2,634,463.47	96.36%	49,478.05	1.88

Komente dhe shpjegime:

Nisur nga vlerësimi i përgjithshëm del se niveli i shpenzimit të buxhetit për vitin 2022 është në shumë prej **2,683,941.52 € apo 91.48%**.

Sipas kategorive ekonomike të shpenzimeve për:

- Paga dhe shtesa janë shpenzuar 1,674,681.79 € apo 95.05 %,
- Mallra dhe shërbime 396,616.33 € apo 96.56 %,
- Shpenzime komunale 67,684.20 € apo 99.98 %,
- Subvencione dhe transfere 85,967 € apo 98.81 % dhe
- Shpenzime kapitale 458,992.20 € apo 75.68 %.

➤ Pagesat nga kategoria ekonomike **paga dhe shtesa** janë shpenzuar në shumë prej 1,674,681.79 € ose 95.05% të planit vjetor, ndërsa krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit 2021 pagesat për këtë kategori kanë një rritje prej 29,636.68 €.

➤ Shpenzimet e kategorisë **mallra dhe shërbime** për periudhën janar-dhjetor 2022 janë 396,616.33 € apo 96.56% e planit vjetor, ndërsa krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit 2021 kemi një rritje prej për 47,875.25 €.

➤ Pagesat për **shpenzime komunale** për periudhën janar-dhjetor 2022 arritën shumën prej 67,684.20 € apo 99.98% e planit vjetor, ndërsa krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit 2021 kemi një rritje prej 2,784.33 €.

➤ Pagesat nga kategoria **subvencione dhe transfere** për periudhën janar-dhjetor 2022 janë në shumë prej 85,967 apo 98.81% e planit vjetor, ndërsa krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit 2021 kemi një rritje prej 13,502 €.

➤ Pagesat nga kategoria **shpenzimet kapitale** janë në shumë prej 458,992.20 € apo 75.68 % e planit vjetor, ndërsa krahasuar me periudhën e njëjtë kemi një rënie të shpenzimit prej 44,320.21 €.

➤ Gjithsej **shpenzimet për periudhën janar-dhjetor 2022**, për të gjitha kategoritë ekonomike të shpenzimeve janë në shumë prej **2,683,941.52 € apo 91.48%** e planit të përgjithshëm vjetor, ndërsa në krahasim me periudhën e njëjtë të vitit paraprak kemi një rritje për 1.88 % apo 49,478.05 €.

6. RAPORTI I EKZEKUTIMIT TË BUXHETIT PËR VITIN 2022 SIPAS DREJTORIVE

Përshkrimi	Buxheti Aktual	Allocated	E paalokuar	Aktuali	Zotim /Obligimet në pritje	Buxheti FreeBalance	Progresi ndaj planit %
CAT / RESP / PCLASS / SUBCL	A	B	A - B	C	D	A - (C + D)	E
04 FINANCIMET NGA HUAMARRJET	20,286.00	20,286.00	0.00	20,286.00	0.00	0.00	100.00
659 HANI I ELEZIT	20,286.00	20,286.00	0.00	20,286.00	0.00	0.00	100.00
75050 SHËRBIMET E KUJDESIT PRIMAR SHËNDETËSOR - HANI I ELEZIT	20,286.00	20,286.00	0.00	20,286.00	0.00	0.00	100.00
11 PAGA DHE SHTESA	20,286.00	20,286.00	0.00	20,286.00	0.00	0.00	100.00
10 BUXHETI	2,417,451.00	2,332,938.34	84,512.66	2,318,493.24	7,536.79	91,420.97	95.91
659 HANI I ELEZIT	2,417,451.00	2,332,938.34	84,512.66	2,318,493.24	7,536.79	91,420.97	95.91
16035 ZYRA E KRYETARIT - HANI I ELEZIT	100,067.00	99,212.91	854.09	99,212.74	0.01	854.25	99.15
11 PAGA DHE SHTESA	77,067.00	76,212.91	854.09	76,212.91	0.00	854.09	98.89
13 MALLRA DHE SHËRBIME	23,000.00	23,000.00	0.00	22,999.83	0.01	0.16	100.00
16335 ADMINISTRATA - HANI I ELEZIT	201,626.00	198,705.35	2,920.65	197,672.45	32.09	3,921.46	98.04
11 PAGA DHE SHTESA	92,521.00	89,600.35	2,920.65	89,600.35	0.00	2,920.65	96.84
13 MALLRA DHE SHËRBIME	65,105.00	65,105.00	0.00	64,072.10	32.09	1,000.81	98.41
14 SHPENZIME KOMUNALE	44,000.00	44,000.00	0.00	44,000.00	0.00	0.00	100.00
16935 ZYRA E KUVENDIT KOMUNAL - HANI I ELEZIT	74,316.83	74,316.83	0.00	74,316.79	0.00	0.04	100.00
11 PAGA DHE SHTESA	64,316.83	64,316.83	0.00	64,316.83	0.00	0.00	100.00
13 MALLRA DHE SHËRBIME	10,000.00	10,000.00	0.00	9,999.96	0.00	0.04	100.00
17535 BUXHETI - HANI ELEZIT	57,165.00	52,124.99	5,040.01	52,124.99	0.00	5,040.01	91.18
11 PAGA DHE SHTESA	54,165.00	49,124.99	5,040.01	49,124.99	0.00	5,040.01	90.70
13 MALLRA DHE SHËRBIME	3,000.00	3,000.00	0.00	3,000.00	0.00	0.00	100.00

18444 PARANDALIMI DHE INSPEKTIMI I ZJARRIT	183,950.39	179,576.58	4,373.81	176,917.39	4.14	7,028.86	96.18
11 PAGA DHE SHITESA	63,800.39	59,426.58	4,373.81	59,426.58	0.00	4,373.81	93.14
13 MALLRA DHE SHËRBIME	63,000.00	63,000.00	0.00	62,994.77	0.18	5.05	99.99
30 PASURITË JOFINANCIARE	57,150.00	57,150.00	0.00	54,496.04	3.96	2,650.00	95.36
19675 ZYRA LOKALE E KOMUNITETEVE - HANI I ELEZIT	6,966.17	6,966.17	0.00	6,966.17	0.00	0.00	100.00
11 PAGA DHE SHITESA	6,466.17	6,466.17	0.00	6,466.17	0.00	0.00	100.00
13 MALLRA DHE SHËRBIME	500.00	500.00	0.00	500.00	0.00	0.00	100.00
47115 PYLLTARIA INSPEKSIONI - HANI I ELEZIT	33,423.00	31,040.55	2,382.45	31,025.53	15.00	2,382.47	92.83
11 PAGA DHE SHITESA	29,923.00	27,540.55	2,382.45	27,540.55	0.00	2,382.45	92.04
13 MALLRA DHE SHËRBIME	3,500.00	3,500.00	0.00	3,484.98	15.00	0.02	99.57
48035 PLANIFIKIMI DHE ZHVILLIMI EKONOMIK - HANI ELEZIT	23,958.00	23,759.82	198.18	23,691.82	66.00	200.18	98.89
11 PAGA DHE SHITESA	21,958.00	21,759.82	198.18	21,759.82	0.00	198.18	99.10
13 MALLRA DHE SHËRBIME	2,000.00	2,000.00	0.00	1,932.00	66.00	2.00	96.60
66480 PLANIFIKIMI URBANIZMI INSPEKSIONI - HANI ELEZIT	189,942.00	184,198.42	5,743.58	178,149.78	6,048.64	5,743.58	93.79
11 PAGA DHE SHITESA	55,942.00	50,198.42	5,743.58	50,198.42	0.00	5,743.58	89.73
13 MALLRA DHE SHËRBIME	4,000.00	4,000.00	0.00	4,000.00	0.00	0.00	100.00
30 PASURITË JOFINANCIARE	130,000.00	130,000.00	0.00	123,951.36	6,048.64	0.00	95.35
73044 ADMINISTRATA - HANI I ELEZIT	16,726.61	16,726.61	0.00	16,681.11	35.75	9.75	99.73
11 PAGA DHE SHITESA	16,226.61	16,226.61	0.00	16,226.61	0.00	0.00	100.00
13 MALLRA DHE SHËRBIME	500.00	500.00	0.00	454.50	35.75	9.75	90.90
75050 SHËRBIMET E KUJDESIT PRIMAR SHËNDETËSOR - HANI I ELEZIT	333,692.00	317,521.34	16,170.66	315,599.27	22.94	18,069.79	94.58
11 PAGA DHE SHITESA	240,531.00	224,360.34	16,170.66	222,470.34	0.00	18,060.66	92.49
13 MALLRA DHE SHËRBIME	64,611.00	64,611.00	0.00	64,578.93	22.94	9.13	99.95
14 SHPENZIME KOMUNALE	8,550.00	8,550.00	0.00	8,550.00	0.00	0.00	100.00
30 PASURITË JOFINANCIARE	20,000.00	20,000.00	0.00	20,000.00	0.00	0.00	100.00

75671 SHËRBIMET SOCIALE - HANI ELEZIT	23,340.00	22,339.65	1,000.35	22,339.63	0.00	1,000.37	95.71
11 PAGA DHE SHTESA	19,540.00	18,539.65	1,000.35	18,539.65	0.00	1,000.35	94.88
13 MALLRA DHE SHËRBIME	2,800.00	2,800.00	0.00	2,799.98	0.00	0.02	100.00
14 SHPENZIME KOMUNALE	1,000.00	1,000.00	0.00	1,000.00	0.00	0.00	100.00
92175 ADMINISTRATA - HANI I ELEZIT	101,813.00	98,807.44	3,005.56	97,228.45	1,129.14	3,455.41	95.50
11 PAGA DHE SHTESA	34,813.00	31,807.44	3,005.56	31,807.44	0.00	3,005.56	91.37
13 MALLRA DHE SHËRBIME	37,000.00	37,000.00	0.00	36,130.92	869.08	0.00	97.65
30 PASURITË JOFINANCIARE	30,000.00	30,000.00	0.00	29,290.09	260.06	449.85	97.63
92890 ARSIMI PARAFILLOR DHE ÇERDHE - HANI I ELEZIT	79,412.00	63,475.51	15,936.49	63,304.40	167.19	15,940.41	79.72
11 PAGA DHE SHTESA	67,162.00	51,225.51	15,936.49	51,225.51	0.00	15,936.49	76.27
13 MALLRA DHE SHËRBIME	10,250.00	10,250.00	0.00	10,078.89	167.19	3.92	98.33
14 SHPENZIME KOMUNALE	2,000.00	2,000.00	0.00	2,000.00	0.00	0.00	100.00
94020 ARSIMI FILLOR - HANI ELEZIT	805,157.00	796,592.11	8,564.89	795,836.62	15.89	9,304.49	98.84
11 PAGA DHE SHTESA	738,173.00	729,608.11	8,564.89	728,986.28	0.00	9,186.72	98.76
13 MALLRA DHE SHËRBIME	57,484.00	57,484.00	0.00	57,366.14	0.09	117.77	99.79
14 SHPENZIME KOMUNALE	9,500.00	9,500.00	0.00	9,484.20	15.80	0.00	99.83
95220 ARSIMI I MESËM - HANI I ELEZIT	185,896.00	167,574.06	18,321.94	167,426.10	0.00	18,469.90	90.06
11 PAGA DHE SHTESA	175,368.00	157,046.06	18,321.94	156,898.76	0.00	18,469.24	89.47
13 MALLRA DHE SHËRBIME	7,878.00	7,878.00	0.00	7,877.34	0.00	0.66	99.99
14 SHPENZIME KOMUNALE	2,650.00	2,650.00	0.00	2,650.00	0.00	0.00	100.00
21 TE HYRAT VETANAKE	381,347.00	313,981.74	67,365.26	243,822.54	57,768.31	79,756.15	63.94
659 HANI I ELEZIT	381,347.00	313,981.74	67,365.26	243,822.54	57,768.31	79,756.15	63.94
16035 ZYRA E KRYETARIT - HANI I ELEZIT	45,000.00	45,000.00	0.00	43,967.00	1,033.00	0.00	97.70
20 SUBVENCIONE DHE TRANSFERE	45,000.00	45,000.00	0.00	43,967.00	1,033.00	0.00	97.70
16335 ADMINISTRATA - HANI I ELEZIT	6,512.00	6,512.00	0.00	6,511.97	0.02	0.01	100.00
13 MALLRA DHE SHËRBIME	6,512.00	6,512.00	0.00	6,511.97	0.02	0.01	100.00
18444 PARANDALIMI DHE INSPEKTIMI I ZJARRIT	70,500.00	62,626.70	7,873.30	48,689.76	11,868.19	9,942.05	69.06

13 MALLRA DHE SHËRBIME	7,000.00	7,000.00	0.00	6,984.63	0.04	15.33	99.78
20 SUBVENCIONE DHE TRANSFERE	8,500.00	8,500.00	0.00	8,500.00	0.00	0.00	100.00
30 PASURITË JOFINANCIARE	55,000.00	47,126.70	7,873.30	33,205.13	11,868.15	9,926.72	60.37
38 REZERVAT	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	#DIV/0!
47115 PYLLTARIA INSPEKSIONI - HANI I ELEZIT	11,500.00	11,500.00	0.00	11,500.00	0.00	0.00	100.00
20 SUBVENCIONE DHE TRANSFERE	11,500.00	11,500.00	0.00	11,500.00	0.00	0.00	100.00
66480 PLANIFIKIMI URBANIZMI INSPEKSIONI - HANI ELEZIT	167,000.00	134,219.15	32,780.85	88,363.06	44,843.18	33,793.76	52.91
13 MALLRA DHE SHËRBIME	2,000.00	2,000.00	0.00	1,979.80	0.00	20.20	98.99
30 PASURITË JOFINANCIARE	165,000.00	132,219.15	32,780.85	86,383.26	44,843.18	33,773.56	52.35
38 REZERVAT	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	#DIV/0!
75050 SHËRBIMET E KUJDESIT PRIMAR SHËNDETËSOR - HANI I ELEZIT	10,635.00	10,001.82	633.18	3,910.14	0.00	6,724.86	36.77
13 MALLRA DHE SHËRBIME	5,635.00	5,001.82	633.18	56.06	0.00	5,578.94	0.99
30 PASURITË JOFINANCIARE	5,000.00	5,000.00	0.00	3,854.08	0.00	1,145.92	77.08
38 REZERVAT	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	#DIV/0!
75671 SHËRBIMET SOCIALE - HANI ELEZIT	200.00	200.00	0.00	158.14	23.92	17.94	79.07
13 MALLRA DHE SHËRBIME	200.00	200.00	0.00	158.14	23.92	17.94	79.07
92175 ADMINISTRATA - HANI I ELEZIT	60,000.00	35,000.00	25,000.00	33,770.40	0.00	26,229.60	56.28
20 SUBVENCIONE DHE TRANSFERE	15,000.00	15,000.00	0.00	15,000.00	0.00	0.00	100.00
30 PASURITË JOFINANCIARE	45,000.00	20,000.00	25,000.00	18,770.40	0.00	26,229.60	41.71
92890 ARSIMI PARAFILLOR DHE ÇERDHET - HANI I ELEZIT	9,750.00	8,922.07	827.93	6,952.07	0.00	2,797.93	71.30
13 MALLRA DHE SHËRBIME	9,750.00	8,922.07	827.93	6,952.07	0.00	2,797.93	71.30
95220 ARSIMI I MESËM - HANI I ELEZIT	250.00	0.00	250.00	0.00	0.00	250.00	0.00
13 MALLRA DHE SHËRBIME	250.00	0.00	250.00	0.00	0.00	250.00	0.00
22 TË HYRAT VETANAKE NGA VITI I KALUAR	72,737.76	72,737.76	0.00	62,485.72	6,073.88	4,178.16	85.91
659 HANI I ELEZIT	72,737.76	72,737.76	0.00	62,485.72	6,073.88	4,178.16	85.91
16035 ZYRA E KRYETARIT - HANI I ELEZIT	7,000.00	7,000.00	0.00	7,000.00	0.00	0.00	100.00
20 SUBVENCIONE DHE TRANSFERE	7,000.00	7,000.00	0.00	7,000.00	0.00	0.00	100.00

16335 ADMINISTRATA - HANI I ELEZIT	2,500.00	2,500.00	0.00	2,500.00	0.00	0.00	100.00
13 MALLRA DHE SHËRBIME	2,500.00	2,500.00	0.00	2,500.00	0.00	0.00	100.00
66480 PLANIFIKIMI URBANIZMI INSPEKSIONI - HANI ELEZIT	50,109.03	50,109.03	0.00	40,009.65	6,055.60	4,043.78	79.85
13 MALLRA DHE SHËRBIME	9,671.27	9,671.27	0.00	9,671.25	0.00	0.02	100.00
30 PASURITË JOFINANCIARE	40,437.76	40,437.76	0.00	30,338.40	6,055.60	4,043.76	75.02
75050 SHËRBIMET E KUJDESIT PRIMAR SHËNDETËSOR - HANI I ELEZIT	10,726.15	10,726.15	0.00	10,650.37	18.28	57.50	99.29
13 MALLRA DHE SHËRBIME	7,226.15	7,226.15	0.00	7,206.37	18.28	1.50	99.73
30 PASURITË JOFINANCIARE	3,500.00	3,500.00	0.00	3,444.00	0.00	56.00	98.40
92890 ARSIMI PARAFILLOR DHE ÇERDHET - HANI I ELEZIT	2,337.58	2,337.58	0.00	2,325.70	0.00	11.88	99.49
13 MALLRA DHE SHËRBIME	2,337.58	2,337.58	0.00	2,325.70	0.00	11.88	99.49
95220 ARSIMI I MESËM - HANI I ELEZIT	65.00	65.00	0.00	0.00	0.00	65.00	0.00
13 MALLRA DHE SHËRBIME	65.00	65.00	0.00	0.00	0.00	65.00	0.00
32 GRANTE TJERA TE JASHTME	30.00	30.00	0.00	0.00	0.00	30.00	0.00
659 HANI I ELEZIT	30.00	30.00	0.00	0.00	0.00	30.00	0.00
66480 PLANIFIKIMI URBANIZMI INSPEKSIONI - HANI ELEZIT	30.00	30.00	0.00	0.00	0.00	30.00	0.00
30 PASURITË JOFINANCIARE	30.00	30.00	0.00	0.00	0.00	30.00	0.00
49 EU-UNIONI EUROPIAN	62,124.45	62,124.45	0.00	59,140.02	0.00	2,984.43	95.20
659 HANI I ELEZIT	62,124.45	62,124.45	0.00	59,140.02	0.00	2,984.43	95.20
66480 PLANIFIKIMI URBANIZMI INSPEKSIONI - HANI ELEZIT	62,124.45	62,124.45	0.00	59,140.02	0.00	2,984.43	95.20
11 PAGA DHE SHITESA	3,880.58	3,880.58	0.00	3,880.58	0.00	0.00	100.00
13 MALLRA DHE SHËRBIME	2,984.43	2,984.43	0.00	0.00	0.00	2,984.43	0.00
30 PASURITË JOFINANCIARE	55,259.44	55,259.44	0.00	55,259.44	0.00	0.00	100.00
59 QEVERIA JAPONEZE	43,809.40	43,809.40	0.00	0.00	0.00	43,809.40	0.00
659 HANI I ELEZIT	43,809.40	43,809.40	0.00	0.00	0.00	43,809.40	0.00
18444 PARANDALIMI DHE INSPEKTIMI I ZJARRIT	0.40	0.40	0.00	0.00	0.00	0.40	0.00
30 PASURITË JOFINANCIARE	0.40	0.40	0.00	0.00	0.00	0.40	0.00

66480 PLANIFIKIMI URBANIZMI INSPEKSIONI - HANI ELEZIT	43,809.00	43,809.00	0.00	0.00	0.00	43,809.00	0.00
30 PASURITË JOFINANCIARE	43,809.00	43,809.00	0.00	0.00	0.00	43,809.00	0.00
60 UN-HABITAT	0.26	0.26	0.00	0.00	0.00	0.26	0.00
659 HANI I ELEZIT	0.26	0.26	0.00	0.00	0.00	0.26	0.00
66480 PLANIFIKIMI URBANIZMI INSPEKSIONI - HANI ELEZIT	0.26	0.26	0.00	0.00	0.00	0.26	0.00
30 PASURITË JOFINANCIARE	0.26	0.26	0.00	0.00	0.00	0.26	0.00
61 QEVERIA ZVICRANE	83.42	83.42	0.00	0.00	0.00	83.42	0.00
659 HANI I ELEZIT	83.42	83.42	0.00	0.00	0.00	83.42	0.00
16335 ADMINISTRATA - HANI I ELEZIT	0.50	0.50	0.00	0.00	0.00	0.50	0.00
13 MALLRA DHE SHËRBIME	0.50	0.50	0.00	0.00	0.00	0.50	0.00
66480 PLANIFIKIMI URBANIZMI INSPEKSIONI - HANI ELEZIT	62.60	62.60	0.00	0.00	0.00	62.60	0.00
30 PASURITË JOFINANCIARE	62.60	62.60	0.00	0.00	0.00	62.60	0.00
94020 ARSIMI FILLOR - HANI ELEZIT	20.32	20.32	0.00	0.00	0.00	20.32	0.00
30 PASURITË JOFINANCIARE	20.32	20.32	0.00	0.00	0.00	20.32	0.00
Totali I Përgjithshëm	2,997,869.29	2,845,991.37	151,877.92	2,704,227.52	71,378.98	222,262.79	90.20

Në këtë tabelë kemi paraqitur buxhetin sipas drejtorive, sipas kategorive ekonomike të shpenzimeve dhe sipas burimeve të financimit për mjetet në disponim, të alokuara, të paalokuara, të shpenzuara, të zotuara, mjetet e lira dhe progresin shprehur në %.

7. EKZEKUTIMI I BUXHETIT PËR VITIN 2022 SIPAS BURIMIT TË FINANCIMIT

<i>Përshkrimi</i>	<i>Buxheti Aktual</i>	<i>Allocated</i>	<i>E paalokuar</i>	<i>Aktuali</i>	<i>Zotim /Obligimet në pritje</i>	<i>Buxheti FreeBalance</i>	<i>Progresi në %</i>
<i>CAT / RESP</i>	A	B	A - B	C	D	A - (C + D)	E
04 FINANCIMET NGA HUAMARRJET	20,286.00	20,286.00	0.00	20,286.00	0.00	0.00	100.00
10 BUXHETI	2,417,451.00	2,332,938.34	84,512.66	2,318,493.24	7,536.79	91,420.97	95.91
21 TE HYRAT VETANAKE	381,347.00	313,981.74	67,365.26	-90,179.13	57,768.31	413,757.82	-23.65
22 TË HYRAT VETANAKE NGA VITI I KALUAR	72,737.76	72,737.76	0.00	62,485.72	6,073.88	4,178.16	85.91
32 GRANTE TJERA TE JASHTME	30.00	30.00	0.00	0.00	0.00	30.00	0.00
49 EU-UNIONI EUROPIAN	65,950.60	65,950.60	0.00	-1,174.15	0.00	67,124.75	-1.78
59 QEVERIA JAPONEZE	43,809.40	43,809.40	0.00	-43,809.00	0.00	87,618.40	-100.00
60 UN-HABITAT	0.26	0.26	0.00	0.00	0.00	0.26	0.00
61 QEVERIA ZVICRANE	83.42	83.42	0.00	0.00	0.00	83.42	0.00
Totali i Përgjithshëm	3,001,695.44	2,849,817.52	151,877.92	2,266,102.68	71,378.98	664,213.78	75.49

Komente dhe shpjegime:

Buxheti nga financimi i huamarrjes në shëndetësi (fondi 04)

Ka qenë në shumë prej 20, 286 €, ku prej këtyre janë shpenzuar 20,286 € apo 100%.

Buxheti nga granti qeveritar (fondi 10)

Ka qenë në shumë prej 2,417,451 €, ku prej këtyre janë shpenzuar 2,318,493.24 € apo 95.91%, kurse suficit kanë mbetur 84,512.66 € apo 3.49%.

Buxheti nga të hyrat vetanake 2022 (fondi 21)

Të hyrat vetanake të planifikuara për vitin 2022 kanë qenë në vlerë prej 381,347 €, ndërsa gjatë vitit 2022 vlera e të hyrave direkte të inkasuara ka arritur 334,001.67 € ose 88%, ndërsa prej këtij fondi kemi shpenzuar 243,822.54 € apo 73% kurse mjetet e mbetura janë në vlerë prej 137,524.46 €.

Buxheti nga të hyrat 2020 dhe 2021 (fondi 22)

Të hyrat e bartura nga viti 2020 dhe viti 2021 është në vlerë prej 72,737.76 €, ku nga këto janë shpenzuar 62,485.72 € ose 85.91% ndërsa të pa shpenzuara kanë mbetur edhe 10,252.04 € apo 14%.

Buxheti nga donacionet (fondet 32, 49, 59, 60 dhe 61)

Fondi 32 ka të bëj me grante tjera të jashtme të cilat kanë qenë të dedikuara për investime kapitale dhe të cilat kanë mbetur si dhe të njejtat barten për çdo vit, por nuk mund të shpenzohen.

Fondi 49 ka qenë në vlerë prej 65,950.60 €, prej të cilave 3,826.15 € janë kthyer ndërsa prej këtij fondi janë shpenzuar 59,140.02 € dhe mbetja është 2,984.43 €.

Fondi 59 ka të bëj me Qeverinë Japoneze ku në këtë fond janë 0.40 € të cilat kanë mbetur nga investimet kapitale nga vitet e kaluara ndërsa gjatë vitit 2022 kemi pranuar donacion nga e njehta Qeveri në vlerë prej 43,809 € në kategorinë e Investimeve Kapitale të cilat do të shfrytëzohen gjatë vitit 2023.

Fondi 60 ka të bëj me UN-Habitat, ku në këtë fond kanë mbetur edhe 0.26 € nga Investime kapitale nga vitet e kaluara të cilat barten vit pas viti.

Fondi 61 ka të bëj me Qeverinë Zvicerane të cilat janë në vlerë prej 83.42 €. Janë përdorur vitet e kaluara, ku 0.50€ janë në kategorinë mallra dhe shërbime , ndërsa pjesa tjetër i takon kategorisë Investime Kapitale , të bartura vit pas viti.

8.SHPENZIMET SIPAS KODEVE EKONOMIKE PËR VITIN 2022

Kodi	Përshkrimi	Shpenzimi janar-dhjetor 2022	Shpenzimi janar-dhjetor 2021	Krahasimi 2022-2021	Krahasimi në %
1	Paga dhe shtesa				
11110	Pagat neto përmes listës së pagave	1,379,999.38	1,389,145.19	(9,145.81)	(0.66)
11115	Pagesa për sindikatë	4,076.83	5,286.51	(1,209.68)	(22.88)
11125	Anëtarësim-Oda e Infermierëve të Kosovës	573.99	662.96	(88.97)	(13.42)
11126	Anëtarësim-Oda e Mjekëve të Kosovës	480.00	560	(80.00)	(14.29)
11400	Punëtorët me kontratë-jo ne listen e pagave	3,283.07	6,329.00	(3,045.93)	(48.13)
11500	Tatimi i ndalur në të ardhurat personale	85,766.42	87,211.95	(1,445.53)	(1.66)
11600	Kontributi pensional-punëtori	76,792.76	77,924.70	(1,131.94)	(1.45)
11700	Kontributi pensional-punëdhësi	76,792.76	77,924.70	(1,131.94)	(1.45)
11900	Pagesa për vendime gjyqësore	67,202.58	-	67,202.58	#DIV/0!
	Totali për paga dhe shtesa	1,694,967.79	1,645,045.01	49,922.78	3.03
2	Mallrat dhe shërbimet	Shpenzimi 2022	Shpenzimi TM2 2021	Krahasimi 2022-2021	Krahasimi në %
13130	Shpenzimet e udhëtimit zyrtar brenda vendit (transporti i nxënësve)	20,512.24	18,546.94	1,965.30	10.60
13140	Shpenzimet e udhëtimit zyrtar jashtë vendit	-	-	0.00	#DIV/0!
13310	Shpenzimet për internet	2,725.00	1,900.00	825.00	43.42
13320	Shpenzimet e telefonisë mobile	8,217.07	12,723.60	-4,506.53	-35.42
13330	Shpenzimet postare	140.70	111.70	29.00	25.96
13141	Shpenzime të vogla - Para xhepi	2,104.40	234.00	1,870.40	799.32
13142	Akomodimi-Udhëtimet zyrtare jashtë vendit	4,460.00		4,460.00	#DIV/0!
13143	Shpenzimet tjera të udhëtimeve zyrtare jashtë vendit	54.00	78.00	-24.00	-30.77
13420	Shërbimet e përfaqësimit-avokaturës	1,456.00	1,730.00	-274.00	-15.84
13430	Shërbime të ndryshme shëndetësore	1,110.29	-	1,110.29	#DIV/0!
13440	Shërbime të ndryshme intelektuale dhe këshilldhënëse	3,905.37	2,812.84	1,092.53	0.00
13450	Shërbimet e shtypit - Jo marketing	570.00	705.00	-135.00	-19.15
13460	Shërbime kontraktuese tjera	57,350.03	27,398.54	29,951.49	109.32
13470	Shërbime teknike	1,462.55	4,544.54	-3,081.99	-67.82
13480	Shpenzimet për anëtarësim	2,400.45	2,400.45	0.00	0.00
13490	Shërbime e varrimit	-	-	0.00	#DIV/0!
13501	Mobilje më pak se 1000 euro	6,740.00	6,322.98	417.02	0.00
13503	Kompjuter më pak se 1000 euro	15,068.00	5,361.40	9,706.60	0.00
13506	Paisje specialistike mjekësore më pak se 1000 €	3,499.00		3,499.00	#DIV/0!
13509	Pajisje tjera me pak se 1000 euro	14,300.80	26,378.52	-12,077.72	0.00
13510	Blerja e librave dhe veprave artistike	-	240.00	-240.00	0.00

13610	Furnizim për zyre	31,048.74	13,418.64	17,630.10	131.39
13620	Furnizim me ushqim dhe pije (jo dreka zyrtare)	25,661.33	21,593.71	4,067.62	18.84
13630	Furnizime mjekësore	13,156.70	13,577.99	-421.29	-3.10
13640	Furnizime pastrimi	6,504.48	8,190.58	-1,686.10	-20.59
13650	Furnizim me veshmbathje	3,784.98	990.00	2,794.98	0.00
13660	Akomodim	-	981.91	-981.91	0.00
13760	Dru	35,138.97	19,270.00	15,868.97	82.35
13770	Derivate për gjenerator	365.06		365.06	#DIV/0!
13780	Karburant për vetura	25,093.80	14,746.87	10,346.93	70.16
13810	Avans për pety cash	-	4,057.50	-4,057.50	-100.00
13917	Provizioni Bankar	152.00	126.00	26.00	20.63
13950	Regjistrimi i automjeteve	1,227.50	1,859.93	-632.43	-34.00
13951	Sigurimi i automjeteve	5,714.84	7,014.97	-1,300.13	-18.53
14010	Mirëmbajtja dhe riparimi i automjeteve	7,877.86	8,659.43	-781.57	-9.03
14020	Mirëmbajtja e ndërtesave	4,041.30	3,142.78	898.52	28.59
14023	Mirëmbajtja e shkollave	22,755.90	18,174.54	4,581.36	25.21
14024	Mirëmbajtja e objekteve shëndetësore	2,509.60		2,509.60	#DIV/0!
14032	Mirëmbajtja e rrugëve lokale	44,151.98	44,179.64	-27.66	-0.06
14050	Mirëmbajtja e mobileve dhe paisjeve	4,009.99		4,009.99	#DIV/0!
14130	Qiraja për paisje	511.31		511.31	#DIV/0!
14140	Qiraja për makineri	2,717.00	3,054.00	-337.00	-11.03
14210	Reklamat dhe konkurset	990.00	-	990.00	#DIV/0!
14220	Botimet e publikimeve	192.00	10,411.50	-10,219.50	-98.16
14310	Drekat zyrtare	11,137.90	8,317.40	2,820.50	33.91
14410	Shpenzime-vendimet e gjykatave	1,797.19	37,830.64	-36,033.45	-95.25
	Totali për mallra dhe shërbime	396,616.33	351,086.54	45,529.79	12.97
3	Shpenzimet komunale	Shpenzimi 2022	Shpenzimi 2021	Krahasimi 2022-2021	Krahasimi në %
13210	Rryma	55,370.13	54,823.15	546.98	1.00
13230	Mbeturinat	11,179.48	9,263.00	1,916.48	20.69
13250	Shpenzimet e telefonisë fikse	1,134.59	813.72	320.87	39.43
	Totali për shpenzime komunale	67,684.20	64,899.87	2,784.33	4.29
4	Subvencionet dhe transferet	Shpenzimi 2022	Shpenzimi 2021	Krahasimi 2022-2021	Krahasimi në %
21200	Subvencione për entitete jo-publike	34,715.12	25,670.00	9,045.12	35.24
22100	Transfere për qeveri tjera	-	-	0.00	#DIV/0!
22200	Pagesë për përfitues individual	51,251.88	46,895.00	4,356.88	9.29
	Totali në subvencione dhe transfere	85,967.00	72,565.00	13,402.00	18.47
5	Investimet kapitale	Shpenzimi 2022	Shpenzimi 2021	Krahasimi 2022-2021	Krahasimi në %
